

Prishtina, qytet ku mbizotëron rregulli dhe ligji



RAPORTI 2016

Prishtina
po bëhet





Vizioni:

Vizioni – Prishtina, qytet ku zbatohet rregulli dhe ligji dhe ku ka qytetari aktive për ruajtjen e hapësirës publike dhe menaxhimin e mirëfilltë të saj.

Para vitit 2014, Prishtina ishte qytet ku mungonte zbatimi i rregullit dhe ligji. Mbi 46,000 objekte të ndërtuar pa leje, kishin sjellë qytetin në ‘vdekje klinike’. Ngufatja e qytetit përmes zaptimit të hapësirës publike dhe ndërtimit pa kritere në pronat publike dhe private, kishte filluar menjëherë pas përfundimit të luftës. Ky trend vazhdoi për 15 vjet me radhë derisa Prishtina u gjet para një situate që shumëkush mendonte se më nuk kishte zgjidhje apo mundësi për ndalim të këtij fenomeni shkatërrues për qytetin dhe qytetarët. Por, fitorja e Lëvizjes VETËVENDOSJE! dhe angazhimi serioz për vendosjen e rregullit dhe ligjit, bëri që Prishtinës t'i kthehet shpresa për t'u bërë qytet normal, që tashmë ishte në prag të kapitullimit.

Tri vjet pas, Prishtina frymon ndryshe. Puna jonë dhe ndihma e pakursyer e qytetarëve, dëshmoi që është e mundur që rregulli dhe ligji të zbatohen dhe të vlejnë njësoj për të gjithë.



Për të vendosur rregullin dhe ligjin në qytet dhe për të bërë riorganizimin e qytetit, nga ne kërkohej që të ishim të pakompromis për rastet të cilët vazhdonin të ndërtonin pa leje apo tejkalonin lejet e ndërtimit.

Çdo informatë që kemi pranuar brenda tri vjetve, është trajtuar me paanshmëri dhe me kujdes të vecantë, dhe në momentin kur është konstatuar shkelja, është vepruar në bazë të ligjit.

Në periudhën trevjeçare u realizuan 124 rrënime të objekteve për banim kolektiv dhe individual, si dhe objekte të tjera, si: anekse, objekte afariste, garazhe, mure rrethuese, e të tjera, të cilat u realizuan në afatin e paraparë. **Në vitin 2014** u realizuan **53 rrënime, 37 rrënime** u realizuan në vitin **2015** dhe **34** në vitin 2016. Ndërsa, në kuadër të inspektimeve të përditshme, inspektorët e sektorit të ndërtimitarisë, kanë shqiptuar mbi 191 gjoba për palët, me vlerë rreth **64,200.00 euro**.

Në të njëjtën kohë, është bërë edhe revokimi i të gjitha lejeve që kanë rezultuar të jenë dhënë në mënyrë të jashtëligjshme.



Komuna e Prishtinë ka fare pak pronë komunale apo pronë publike, e cila është e mirë e përbashkët. Për 15 vjet me radhë prona publike është usurpuar, shfrytëzuar, por edhe shkatërruar. Nga viti 2014, Komuna e Prishtinës ka ndërmarrë aksione të njëpasnjëshme për lirimin e pronave publike dhe kthimin e tyre në pronësi të Komunës së Prishtinës dhe në shfrytëzim sa më mirë të saj për qytetarët.

Hapi i parë që ka ndërmarrë Komuna e Prishtinës në mbrojtjen e pronës publike dhe ndalimin e shfrytëzimit dhe keqpërdorimit të tyre për përfitime personal, ka qenë evidentimi i të gjitha pronave komunale. Në vitin 2014 nuk ka ekzistuar asnjë listë me pronat komunale dhe informata rreth shfrytëzuesve të këtyre pronave. Mungesa e evidencës, nuk do të thotë se udhëheqësit e mëparshëm komunalë nuk kanë pasur dijeni rreth tyre. Të gjitha informatat rreth usurpimeve dhe shfrytëzimeve të pronave komunale, kanë qenë në dispozicion vetëm për disa zyrtarë komunalë.

Në vitin 2014, evidentimi i të gjitha pronave komunale u bë prioritet. Për më pak se dy vjet, Komuna e Prishtinës arriti të bëjë evidentimin e pothuajse të gjitha pronave komunale, nga e cila u kuptua se janë gjithsej 6.183 prona komunale. Po ashtu, u evidentua se shfrytëzues për të gjitha zonat kadastrale janë 4.005, shfrytëzimi i pronave komunale për bujqësi janë 300, ndërsa shfrytëzimi i pronave komunale me objekte është 2.854.

Hapi i dytë pas evidentimit të tyre, ishte lirimi i pronave të uzurpuara. Gjatë periudhës tre vjeçare janë liruar dhjetëra prona publike, 384 lokacioneve publike nga tavolinat dhe karrigjet e lokaleve afariste, largimin e 283 shitësve ambulantë, 8 aksione për largime të vazove të betonit etj.

Vlerësimi i pronës komunale

Vlera e tokës komunale	2,207,257,260.90€
Ndërsa vlera e objekteve	148,163,224.50€
Vlera Totale:	2,355,420,485.40€

Digjitalizim i pronave publike - Databaza e digjitalizuar mundëson evidentimin digjital të të gjitha hapësirave publike të dhëna në shfrytëzim. Pas paraqitjes së kërkesës në Drejtorinë përkatëse dhe pas dhënies në shfrytëzim, mund të informoheni rreth skadimit të kontratës, emrin e lokalit, emrin e pronarit, çmimin që paguan shfrytëzuesi, si dhe sipërfaqen e lejuar për shfrytëzim.

Duke shfrytëzuar 'Google Maps', qytetarët shumë shpejt do të mund të shikojnë në çdo moment statusin e të gjitha pronave publike:

- a janë të lira;
- kush është qiramarrësi;
- për sa vjet është dhënë prona;
- çmimi i pronës;
- kur skadon kontrata etj.

Largimi i transportuesve të kufomave nga prona publike përballë QKUK-së dhe gjelbërimi i asaj pjese - Me qëllim përmirësimin dhe shtimin e sigurisë në transportin urban, Sektori i rendit komunal që vepron në kuadër të Drejtorisë së Inspeksionit, ka bërë konfiskimin e rreth 1200 automjeteve - taksi ilegalë.

Lirimi i hapësirave publike nga uzurpimet me mjete statike/mobile në trotuare; shitësit ambulantë; veturat e fjetura; mallrat e ekspozuara pa leje; e të ngjashme.



Lirimi i 384
lokacioneve
publike nga
tavolinat
dhe karriget
e lokaleve
afariste

Lirimi i
hapësirave
publike nga
uzurpimet me
mjete statike
apo mobile



Përveç lirimit të hapësirave publike, ndalimit të degradimit të qytetit duke penguar dhe ndaluar ndërtimet pa leje, prioritet i qeverisjes në Komunën e Prishtinës ka qenë dhe vazhdon të jetë, mbrojtja e qytetarëve nga objektet që rrezikojnë jetën e tyre.



Prioritet i kësaj qeverisje për këto tri vjet ka qenë edhe mbrojtja e qytetarëve përmes rrënimit të shtëpive/objekteve me rrezikshmëri të lartë. Janë rrënuar 120 objekte me rrezikshmëri të lartë. Një nga rastet më të dalluara ishte objekti i vjetër në qendër të qytetit, në rrugën "Fehmi Agani". Pas inicimit të procedurave dhe ngritjes së shqetësimit për rrezikshmërinë që paraqiste ky objekt, dhe pas evakuimit të familjes e cila jetonte në të, Sektori i ndërtimit rrënoi objektin në fjalë.

Po ashtu, kujdes i veçantë i është kushtuar ndërhyrjeve në raste emergjente të shkaktuara nga fatkeqësítë natyrore apo të shkaktuara nga faktori njeri- vërshimet në vitet e fundit, si dhe në rastet ku faktori njeri ka qenë shkaktar i rrezikut.

Janë rrënuar 120 objekte me rrezikshmëri të lartë.

Rregulli dhe ligji nuk mund të mbizotërojnë aty ku shkelësit vazhdojnë me avazin e vjetër. Hapat e parë që ndërmorrëm, ishin largimi nga puna i zyrtarëve komunalë të dyshuar për keqpërdorim të detyrës zyrtare, mashtrim dhe korruption.

Komuna e Prishtinës në vitet 2014 dhe 2015, ka pezulluar 52 zyrtarë komunalë për keqpërdorim të detyrës zyrtare. Edhe pse ka fakte të mjaftueshme që dëshmojnë për keqpërdorim të detyrës zyrtare dhe korruption, Komisioni ka kthyer në punë 21 persona të suspenduar.

Ndërsa, në 90 raste kemi kuptuar se ka pasur keqpërdorim të detyrës zyrtare, mashtrim dhe korruption. Të gjitha këto raste janë dërguar në Prokurorinë e Shtetit, të cilat ende janë në procedurë gjyqësore.

Menjëherë filluam me zbatimin e plotë të Ligjit për Parandalimin e Shpëlarjes së Parave dhe Financimit të Terrorizmit. Ky ligj nuk ishte zbatuar plotësisht deri më 01.04.2014. Për të siguruar që të gjitha kompanitë private që kryejnë shërbime për Komunën e Prishtinës, filluam me vërejtjet dhe shkëputjet e kontratave me ato kompani që tentonin të mashtronin, apo të mos ofronin shërbime ashtu siç ofertonin.

Shkëputja e kontratës dhe padia ndaj "HIB Petroll-it" - Komuna ka identifikuar se nëpër shkollat e komunës së Prishtinës, nga 42 mostra që janë testuar, është vërtetuar se është përdorur lëndë djegëse e dëmshme. Prokuroria ka vërtetuar se në të gjitha shkollat, niveli i sulfurit ka qenë deri në 80 herë më i madh se niveli i lejuar. Komuna për të vërtetuar nivelin e lartë të sulfurit, ka dërguar mostrat për analiza edhe në një laborator jashtë vendit (në Itali) dhe rezultatet janë të njëjta, niveli i sulfurit ka qenë 800ppm teksa norma e lejuar është 10ppm.

Shkëputja e kontratës me kompaninë "Beni Dona Plast" – pas disa vërejtjeve ndaj kompanisë për mos respektimin e plotë të kontratës dhe duke marrë parasysh dëmet që mund të ishin shkaktuar nga pakujdesia e qëllimshme e kompanisë në shëndetin e fëmijëve, Komuna, në muajin maj të vitit 2015, ka ndërprerë kontratën "Furnizimi me shujta për nxënës të klasave 1-5" dhe i është ndaluar konkurrimi në tenderët e Komunës së Prishtinës.

Shkëputja e kontratës me kompaninë N.T.P. "Douglas" – pas konstatimit se punimi i dollapëve në shkolla nuk është bërë në përputhje të plotë me kontratën, Komuna e Prishtinës ka marr vendim për ndërprerjen e kontratës "Furnizimi dhe montimi i dollapëve për ciklet e ulëta të shkollave fillore të komunës së Prishtinës" dhe ka ndaluar këtë kompani të marrë pjesë në tenderët e Komunës së Prishtinës në të ardhmen.

Shkëputja e kontratës me kompaninë "Alkoimpex" – në janar të vitit 2015, Komuna e Prishtinës ka shkëputur kontratën për mirëmbajtjen dimërore të rrugëve, të lidhur në vitin 2013, për shkak të performancës së dobët dhe ankesave të shumta nga qytetarët. Shkëputja e kontratës me kompaninë "Europa Partners" – në janar të vitit 2015, Komuna e Prishtinës ka shkëputur kontratën për mirëmbajtjen dimërore të rrugëve të lidhur në vitin 2013, për shkak të performancës së dobët dhe ankesave të shumta nga qytetarët. Shkëputja e kontratës me kompanitë "NOTI", "Perspektiva" dhe "Gjashtë Vellezërit Batatina" për shkelje të kontratës.

Shkëputja e kontratës me marrëveshje me kompanitë "Megi Bau", "Idriz Seferi" dhe "Kawa Group" për shkak të pamundësisë për

realizimin e punëve të përcaktuara në kontratë.

Mbrojtja e shëndetit të përgjithshëm - Sektori i Rendit komunal, gjatë vitit 2016 ka mbyllur rrëth 42 lokale, të cilat nuk ishin pajisur me dokumente përkatëse, i është përgjigjur shqetësimëve të qytetarëve gjatë epidemisë së gjedhëve, bashkëpunimi me institucionë të tjera, me qëllim evitimin e rrezikshmërisë.



Mbrojtja e të miturve përmes masave ndaj subjekteve afariste që i kufizon ligji të operojnë në afërsi të shkollave - Meqë Ligji për Lojërat e Fatit parashev që këto të janë të paktën 1.5 km larg institucioneve edukativo-arsimore, dhe të paktën 500m larg njëra tjetrës, Drejtoria e Inspeksionit, në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, Doganën dhe Agjencionin Tatimor të Kosovës, ka bërë mbylljen e mbi 50 lokaleve të lojërave të fatit.



Mbrojtja e ambientit përmes mbrojtjes së pyjeve - Sektori i Pylltarisë këtë vit është transferuar në Drejtoren e Inspeksionit. Kjo ka rezultuar me përparim të dukshëm për sa i

përket rritjes së kontrollit dhe kujdesit ndaj pyjeve në Komunën e Prishtinës. Sivjet janë lëshuar 127 leje për prerje të pyjeve private, mirëpo në rastet kur është hasur në sasi drusore të prerë pa leje, kanë pasuar konfiskimet. Si rezultat i kontrollit të vazhdueshëm, kanë qenë 50 raste të konfiskimeve, me gjithsej 130 metër kub dru, 10 motosharra, automjete, si dhe mjete të tjera. Nga ky sektor janë iniciuar për gjykatë 197 lëndë, prej të cilave 122 për kundërvajtje dhe 75 për vepër penale.

Mbrojtja e ambientit përmes ndalimit të praktikave të dëmshme – si për shembull ndezja e gomave gjatë festës së "1 Majit", si dhe ndalimi i ndezjes së mbeturinave.



Mbrojtja e ambientit përmes eliminimit të deponive me mbeturina inerte – gjatë periudhës trivjeçare, **janë pastruar mbi 200 deponi** në tërë territorin e komunës së Prishtinës. Disa prej tyre tashmë janë shndërruar në parqe.



Digjitalizimi i procesit të punës në Drejtorinë e Inspektionit

Për të shtuar efikasitetin e punës dhe për shkak të shpejtësisë së veprimit që kërkonet në terren, si dhe të shpejtësisë së identifikimit, procedimit të rasteve dhe marrjes së vendimeve, kemi digjitalizuar procesin e punës në Drejtorinë e Inspektionit. Përmes procesit të digjitalizuar do të bëhet regjistrimi i lajmërimeve, identifikimi i rasteve, procedimi i rasteve sipas rrjedhës, si dhe mbyllja e rastit apo dërgimi në një instancë tjetër. I gjithë procesi regjistrohet dhe arkivohet.

Digjitalizmi ka lehtësuar punën e inspektorëve, të cilët mund të komunikojnë direkt me sallën operative për të dërguar informacionet e nevojshme sa herë që hasin në parregullsi. Pastaj, informacioni përpunohet tutje nga zyrtari përkatës, dhe në fund mbylljet si rast ose dërgohet në instanca të tjera. Inspektorit në terren i kthehet forma e shkruar e procesverbalit apo vendimit, të cilin e printon dhe ia jep palës në vendngjarje.

Gjatë periudhës trevjeçare është bërë edhe incizimi gjeodezik i hapësirave të përbashkëta banesore në qytetin e Prishtinës. Ky incizimi ka për qëllim identifikimin, skicimin, matjen e drejtpërdrejtë në terren dhe krijimin e një baze të të dhënave për hapësirat e përbashkëta banesore në komunën e Prishtinës.

Incizimi gjeodezik i hapësirave të përbashkëta, është realizuar në 145 objekte kolektive të banimit, pra përafersisht 20% e ndërtesave në Prishtinë, në gjithsej pesë lokacione të ndryshme. Projekti është realizuar në 4 zona / lagje, dhe atë në zonën "Qendër" të Prishtinës, konkretisht në pjesët e quajtura: kompleksi banesor "Qafa" dhe sheshi "Nëna Terezë", ku janë rilevuar objektet banesore, si dhe janë skicuar, matur hapësirat e përbashkëta banesore dhe punuar rreth 29,70 %, në lagjen "Dardania" - 11,86 % dhe në lagjen "Ulpiana" -11,86 %.

Ky projekt ka vazhduar edhe në vitin 2016 dhe është bërë incizimi gjeodezik i hapësirave të përbashkëta banesore në 71 objekte kolektive të banimit dhe është realizuar në lagjen "Ulipana" – 18.08 %, "Dardania" 16.92% si dhe në zonën "Qendër" - 4.54 %.

Krijimi i kadastrit të përçojave nëntokësore - Në vitin 2015, është realizuar projekti kapital

"Krijimi i kadastrit të përçojave nëntokësore" në komunën e Prishtinës. Detyra e projektit për ndërtimin e kadastrit të përçojave dhe objekteve nëntokësore, është rilevimi (kompletimi) i të gjitha përçojave dhe objekteve nëntokësore dhe paraqitja e tyre në pjesën grafike dhe tekstuale. Llojet e përçojave dhe objekteve nëntokësore, janë: rrjeti i ujësjellësit, i kanalizimit, i nxehje sjellësit, elektroenergetike, telekomunikuese, e naftësjellësit, e gazsjellësit, drenazhe, tunelet e përbashkëta, përçaja industriale, objektet nëntokësore (garazhet, rezervuarët, kalimet e këmbësoreve, tunelet, strehimoret, bodrumet dhe të tjera të ngjashme. Me këtë projekt ka përfunduar evidentimi i të gjitha përçojave nëntokësore në regjionin e Prishtinës dhe është bërë evidentimi i këtyre përçojave në data bazë. Këto të dhëna përveç që përdoren në Drejtorinë e Kadastrit dhe në Agjension Kadastral, përdoren edhe nga Drejtoria e Urbanizmit.



Prishtina
po bëhet